



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: PRANUAR DËRZUAR: DATUM: PRINILJENI DOSTAVLJENI:		19-09-2024	
DATE: RECEIVED/SUBMITTED:			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
01	10	1446	25



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/10 qershor 2016), si dhe Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO79/23.

Auditori i Përgjithshëm, miraton:

RREGULLORE (ZKA) Nr. 03/2024
PËR KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS
NË ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohet klasifikimi i vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ZKA).
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të punësuarit në ZKA.

Neni 2 Kriteret për klasifikimin e vendeve të punës

1. Kriteret për klasifikimin e vendeve të punës, janë:
 - 1.1. **Përgjegjësia**- përcakton nivelin e përgjegjësisë së vendit të punës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ZKA, vendimmarrje, menaxhim të të punësuarit dhe burimeve tjera;
 - 1.2. **Kompleksiteti**- përcakton nivelin e ndërlikueshmërisë dhe llojllojshmërisë së detyrave të punës;
 - 1.3. **Kualifikimet**- përcaktojnë nivelin e arsimimit, trajnimeve dhe njohurive përkatëse për ushtrimin e detyrave të vendit të punës;
 - 1.4. **Përvoja profesionale**- përcakton detyrat, natyrën dhe cilësinë e përvojës së punës, të ndërlidhur drejtpërdrejtë me profesionin e të punësuarit;
 - 1.5. **Përvoja menaxheriale**- nënkupton menaxhimin e proceseve audituese dhe jo-audituese duke përfshirë edhe udhëheqjen e auditimit;
2. Detyrat dhe përgjegjësitë për secilin titull të pozitës së punës përcaktohen me akt të veçant për përshkrimin e detyrave të punës.

Neni 3 Kategoritë e klasifikimit të vendeve të punës

1. Vendet e punës në ZKA klasifikohen në këto kategori funksionale:
 - 1.1. **Kategori e lartë drejtuese**, përfshinë vendet e punës të përcaktuara me neni 9.2 të Ligji përkatsë për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit;
 - 1.2. **Kategori e mesme drejtuese**, përfshinë drejtorët e departamenteve dhe njësitë të veçanta organizative;
 - 1.3. **Kategori e ulët drejtuese**, përfshinë pozitat e punës “udhëheqësit e Njësitë dhe Divizioneve;
 - 1.4. **Kategori profesionale**, përfshinë kategorinë që zbaton detyra profesionale dhe që nuk ka përgjegjësi mbikëqyrëse;



1.5. **Kategori mbështetëse**, përfshinë kategorinë e personelit që kryen mbështetje administrative dhe teknike për nevoja të ZKA-së.

KAPITULLI II KATEGORIA E LARTË DREJTUESE

Neni 4 Zëvendës Auditor i Përgjithshëm

1. Me autorizim të Auditorit të Përgjithshëm, Zëvendës Auditori i Përgjithshëm ushtron të gjitha funksionet dhe kryen të gjitha detyrat dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik ose administratë publike;
 - 2.2. Përvoja Profesionale: Tetë (8) vite përvojë në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike, drejtësisë ose administratës, prej tyre pesë (5) vite përvojë menaxheriale;
 - 2.3. Certifikimi: Të jetë Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A9.

Neni 5 Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

1. Ndihmës Auditori i Përgjithshëm, mbështet Auditorin e Përgjithshëm në varësi të delegimit të detyrave dhe përgjegjësi.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik ose administratë publike;
 - 2.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune në fushën e auditimit të jashtëm, prej tyre pesë (5) vite përvojë menaxheriale.
 - 2.3. Certifikimi: Të jetë Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – A10.

Neni 6 Drejtor i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për tërë mbështetjen administrative.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik ose administratë publike;
 - 2.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave ose administratë prej tyre katër (4) vite përvojë menaxheriale;
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X3.

KAPITULLI III
KATEGORIA E MESME DREJTUESE

Neni 7

Drejtor i Departamentit të Auditimit

1. Drejtori i departamentit të auditimit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e ekipeve të auditimit ose mbikëqyrjen e funksioneve përkatëse në menaxhimin e cilësisë në auditim.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti ose master në ekonomi, juridik, administratë publike ose Inxhinierisë;

2.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku 5 vite në auditim të jashtëm, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale;

2.3. Certifikimi: Të jetë Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik.

3. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës në auditimet e performancës dhe të prokurimit, janë:

3.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti ose master në ekonomi, juridik, administratë publike, shëndetsi ose Inxhinieri;

3.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim të jashtëm, si dhe tre (3) vjet përvojë menaxheriale ;

3.3. Certifikimi: Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik:

3.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

4. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës në auditimet e sistemeve të TI-së, janë:

4.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat kompjuterike, ekonomi, ose inxhinierisë;

4.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku tre (3) vite në fushën e TI-së, si dhe tre (3) vjet përvojë menaxheriale ;

4.3. Certifikimi: Certifikat për auditor nga fusha e TI-së;

4.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

5. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B5.

Neni 8

Drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë në fakultetin juridik;

2.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në çështje juridike, prej tyre tre (3) vite përvojë menaxheriale;

2.3. Preferohet Provimi i Jurisprudencës.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B5.

Neni 9

Drejtor i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar për Auditim

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencë shoqërore;

2.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në gazetari, komunikim masiv, bashkëpunim ndërkombëtar apo të ngjashme, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale;

2.3. Njohuri e gjuhës angleze.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B5.

Neni 10

Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencë shoqërore;

2.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në administratë, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X4.

Neni 11

Drejtor i Departamentit për Buxhet, Financa dhe Raportim

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në fushën e ekonomisë;

2.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në buxhet dhe financa, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X4.

Neni 12

Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përbashkëta

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në administratë publike, juridik, ekonomik ose inxhinieri;

2.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në menaxhimin e logjistikës ose shërbimeve tjera të përbashkëta, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X4.

Neni 13

Drejtor i Departamentit për Teknologji të Informacionit

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në fushën e Inxhinierisë;

2.2. Përvoja profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B5.

Neni 14

Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm

1. Drejtori i këtij departamenti zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë e auditimit të mbrendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në fushën e ekonomisë, juridik ose administratë publike;

2.2. Përvoja profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në fushën e auditimit të brendshëm, prej tyre tre (3) vjet përvojë menaxheriale;

2.3. Certifikimi: Të jetë i certifikuar për auditim të brendshëm.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – W7.

MA E N
NALNA
JREZUAR
IDOSTA
SUMMIT
3-
m-
t

Neni 15
Udhëheqës i Njesisë së Prokurimit

1. Udhëheqësi i kësaj njësie ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të njësisë.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në juridik, ekonomi ose administratë publike;
 - 2.2. Përvoja Profesionale: Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në fushën e prokurimit publik;
 - 2.3. Certifikimi: Të jetë i certifikuar për prokurim publik sipas legjislacionit në fuqi.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X4.

KAPITULLI IV
KATEGORIA E ULËT DREJTUESE

Neni 16
Udhëheqës i Njesisë Kundër Mashtrimit

1. Udhëheqësi i kësaj njësie ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të njësisë.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në juridik;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në drejtësi, administrat, prokurim apo auditim;
 - 2.3. Preferohet provimi i jurisprudencës ose certifikime në fushën kundër mashtrimit.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B7.

Neni 17
Udhëheqës i Njesisë për Çështje Juridike dhe Përfaqësim Gjyqësor

1. Udhëheqësi i kësaj njësie ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të njësisë.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në juridik;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në drejtësi, apo administratë;
 - 2.3. Preferohet provimi i jurisprudencës ose provoj në përfaqësim.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B7.

Neni 18
Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa

1. Udhëheqësi i këtij Divizioni zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në fushën e ekonomisë;
 - 2.2. Provoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në buxhet dhe financa ose kontabilitet.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X5.

Neni 19
Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë

1. Udhëheqësi i këtij Divizioni zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti, juridik, ekonomik, administrat publike ose inxhinieri;
 - 2.2. Provoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administratë ose logjistikë;
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X5.

Neni 20
Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Lektyrimit dhe Përkthimit

1. Udhëheqësi i Divizionit zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;
 - 2.2. Provoja profesionale: Tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e përkthimit;
 - 2.3. Njohje e gjuhës serbe ose angleze.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X5.

Neni 21
Udhëheqës i Divizionit për Administrimin e Dokumentacionit

1. Udhëheqësi i këtij Divizioni zbaton autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;

2.2. Provoja Profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administrim të dokumentacionit.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X5.

KAPITULLI V KATEGORIA PROFESIONALE

Neni 22 Auditor i Brendshëm

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës për auditor të brendshëm, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik ose administratë publike;
 - 2.2. Përvoja profesionale: pesë (5) vite përvojë pune profesionale në fushën e auditimit të brendshëm;
 - 2.3. Certifikimi: Të jetë i certifikuar për auditim të brendshëm.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – W13.

Neni 23 Auditor specialist

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës auditor specialist në auditimet financiare të pajtueshmërisë, metodologjisë, cilësisë, planifikim strategjik dhe analizë, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik, administratë publike ose TI;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku tre (3) vite në auditim të jashtëm, si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e shtatë (7) auditimeve të jashtme;
 - 2.3. Certifikimi: Të jete Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik.
3. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, auditor specialist në auditimet e performancës, janë:
 - 3.1. Arsimimi: Diplomë Master në ekonomi, juridik, administratë publike, shkenca politike, shëndetësi ose Inxhinierisë;
 - 3.2. Përvoja Profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre së paku tre (3) vite në auditim të performancës apo të pajtueshmërisë, si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e katër (4) auditimeve;
 - 3.3. Certifikimi: Të jetë i certifikuar për auditorë të jashtëm, certifikim ndërkombëtar apo vendor në fushën e auditimit të performancës;
 - 3.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

4. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e teknologjisë së informacionit, janë:

4.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, inxhinieri, shkenca kompjuterike apo sisteme të informacionit;

4.2. Përvoja profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, prej tyre së paku tre (3) vite në fushën e auditimit, si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e katër (4) auditimeve;

4.3. Certifikimi: Certifikat për auditor nga fusha e TI-së;

4.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

5. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – Z1.

Neni 24

Ekspert i Auditorit në fushën e ndërtimtarisë

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në fushën e ndërtimtarisë;

2.2. Përvoja profesionale: Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në projektim, menaxhim, vlerësim ose mbikqyrje të projekteve në fushën e ndërtimtarisë.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – Z1.

Neni 25

Ekspert i Auditorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e teknologjisë së informacionit, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, inxhinieri, shkenca kompjuterike apo sisteme të informacionit;

2.2. Përvoja profesionale: Gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, prej tyre së paku tre (3) vite në fushën e auditimit, si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e katër (4) auditimeve;

2.3. Certifikimi: Certifikat për auditor nga fusha e TI-së;

2.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B6.

Neni 26
Analist për planifikim dhe raportim

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik ose administratë publike;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në analiza, planifikim dhe raportim në fushën e ekonomisë dhe financave;
 - 2.3. Preferohet njohja e gjuhës angleze.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – Z3.

Neni 27
Auditor Senior

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, administratë publike ose Inxhinierisë;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre 3 vite në auditim të jashtëm si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e tre (3) auditimeve të jashtme;
 - 2.3. Certifikimi: Të jete Auditor i certifikuar ose Auditor i certifikuar i sektorit publik.
3. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e performancës, janë:
 - 3.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik, administratë publike, shkencë politike, shëndetësi ose Inxhinierisë;
 - 3.2. Përvoja profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre së paku tre (3) vite në auditim të performancës apo të pajtueshmërisë, si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e dy (2) auditimeve;
 - 3.3. Certifikimi: Të jetë i certifikuar për auditorë të jashtëm, certifikim ndërkombëtar apo vendor në fushën e auditimit të performancës;
 - 3.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
4. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e teknologjisë së informacionit, janë:
 - 4.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, inxhinieri, shkencë kompjuterike apo sisteme të informacionit;
 - 4.2. Përvoja profesionale: Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, prej tyre së paku tre (3) vite në fushën e auditimit, si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e dy (2) auditimeve;

- 4.3. Preferohet certifikim për auditor nga fusha e TI-së;
 - 4.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
5. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – Z2.

Neni 28 **Auditor**

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridikut, administratë publike ose Inxhinierisë;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Katër (4) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë, prej tyre së paku dy (2) vite në auditim të jashtëm;
 - 2.3. Certifikimi: Të ketë Certifikatë për kontabilist ose Certifikatë për auditor të sektorit publik;
3. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e performancës, janë:
 - 3.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridikut, administratë publike, shkenca politike, shëndetësi ose Inxhinierisë;
 - 3.2. Përvoja profesionale: Katër (4) vite përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre dy (2) vite në auditimin e performancës apo të pajtueshmërisë;
 - 3.3. Certifikim: Të ketë certifikatë për auditorë të jashtëm, certifikatë ndërkombëtar apo vendor në fushën e auditimit të performancës;
 - 3.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
4. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e teknologjisë së informacionit, janë:
 - 4.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, inxhinieri, shkenca kompjuterike apo sisteme të informacionit;
 - 4.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, preferohet përvojë pune në fushën e auditimit;
 - 4.3. Preferohet certifikim për auditor nga fusha e TI-së;
 - 4.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
5. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – Z3.

Neni 29
Auditor junior

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomik, juridik, administratë publike, matematikë financiare në banka dhe sigurime ose Inxhinierisë;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë;
 - 2.3. Certifikimi: Të ketë certifikatë si teknik kontabilitetit, asistent-auditor i sektorit publik ose auditor i brendshëm.
3. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë në auditimet e performancës janë:
 - 3.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik, administratë publike, shkenca politike, shëndetësi, komunikimit ose inxhinierisë;
 - 3.2. Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune profesionale në hulumtim, analiza, financa ose auditim;
 - 3.3. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
4. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – Z4.

Neni 30
Administrator i Sistemit

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në inxhinieri, shkencat kompjuterike apo sisteme të informacionit;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në administrim dhe zbatim të sistemeve të TI-së, në Windows Server dhe Email Server, prej tyre dy (2) vite përvojë në konfigurim dhe menaxhim të firewall -ve;
 - 2.3. Preferohet certifikime si Microsoft Certified System Administrator (MCSA) dhe njohuri të sistemeve për backup dhe menaxhim të log fajllave;
 - 2.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B6.

Neni 31
Administrator i bazave të të dhënave

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në inxhinieri, shkencat kompjuterike apo sisteme të informacionit;

2.2. Provoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në përkrahje të aplikacioneve, përpunimin dhe analizë e të dhënave, prej tyre së paku një (1) vit përvojë pune në mirëmbajtjen e bazave të të dhënave në SQL;

2.3. Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së informative në Excel SQL, Python;

2.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B6.

Neni 32

Specialist i Teknologjis së Informacionit për rrjet dhe harduer

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në inxhinieri, shkencat kompjuterike apo sisteme të informacionit;

2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale më menaxhim të rrjetit dhe pajisjeve të rrjeti si switcha dhe routerë, prej tyre një (1) vit në konfigurim dhe rregullim të pajisjeve të TI si laptop, PC, Monitor;

2.3. Preferohet certifikim si Computing Technology Industry Association (Comp TIA);

2.4. Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B7.

Neni 33

Specialist i mbështetjes për sisteme

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në inxhinieri, shkencat kompjuterike apo sisteme të informacionit;

2.2. Provoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në analizë dhe përkrahje të aplikacioneve si dhe përpunimin e të dhënave;

2.3. Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së informative në Excel SQ, Python; Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – B7.

Neni 34
Këshilltar i lartë juridik kundër mashtrimit

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë të fakultetit juridik;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në çështje juridike, prokurim apo auditim;
 - 2.3. Preferohet provimi i jurisprudencës ose certifikat kundër mashtrimit.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X1.

Neni 35
Këshilltar i lartë Juridik për
për Çështje Juridike dhe Përfaqësim Gjyqësor

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë të fakultetit juridik;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tri (3) vite përvojë pune profesionale në çështje juridike, administratë, apo auditim;
 - 2.3. Preferohet provimi i jurisprudencës ose përvojë në përfaqësim.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X1.

Neni 36
Këshilltar Juridik për
për Çështje Juridike dhe Përfaqësim Gjyqësor

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë të fakultetit juridik;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në çështje juridike, administratë apo auditim.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X2.

Neni 37
Zyrtar për Bashkëpunim

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore ose komunikim;
- 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën komunikimit, ose administratë.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6.

Neni 38
Zyrtar për Komunikim me Publikun

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në fushën e gazetarisë ose komunikimit masiv;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në gazetari apo komunikim;
 - 2.3. Preferohet njohuri të gjuhës angleze.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6.

Neni 39
Zyrtar për Dizajn dhe Grafik të Publikimeve

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë në fakultetin e arteve, ose dizajnit;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën arteve apo dizajnit grafik;
 - 2.3. Preferohet certifikim nga fusha përkatëse.
4. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – K6.

Neni 40
Zyrtar për Zhvillim Profesional

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administratë apo burime njerëzore.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6.

Neni 41
Zyrtar për Burime Njerëzore

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administratë apo burime njerëzore.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X7.

Neni 42
Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administratë, buxhet dhe financa.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6.

Neni 43
Zyrtar për Buxhet dhe Financa

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administratë, buxhet dhe financa.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X7.

Neni 44
Zyrtar Certifikues

1. Kjo pozitë pune zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në buxhet apo financa;
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X5.

Neni 45
Zyrtar për Logjistikë

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administrat ose logjistik.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X7.

Neni 46
Përkthyes

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
 - 2.3. Preferohet çertifikatë/licencën në përkthim të gjuhës serbe/angleze.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6.

Neni 47
Lektor

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në gjuhë dhe letërsi;
 - 2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – E9.

Neni 48
Zyrtar për prokurim

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.
2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:
 - 2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në juridik, ekonomi ose administratë publike;
 - 2.2. Përvoja Profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e prokurimit publik;
 - 2.3. Të jetë i certifikuar për prokurim publik sipas legjislacionit në fuqi.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6.

Neni 49

Zyrtar për regjistrim dhe ruajtje të materialit arkivor

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkenca shoqërore;

2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune në administratë.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X6.

KAPITULLI VI KATEGORIA MBËSHTETËSE

Neni 50

Zyrtar për administrim të dokumenteve

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkenca shoqërore;

2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune në administratë.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X7.

Neni 51

Vozitës

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

2.1. Arsimimi: Shkollë e mesme;

2.2. Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune;

2.3. Patent shofer (kategoria B).

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X10.

Neni 52

Mirëmbajtës i objektit dhe shërbimeve postare

1. Kjo pozitë e punës zbaton detyrat profesionale sipas legjislacionit përkatës.

2. Kualifikimet e kërkuara për këtë pozitë janë:

2.1. Arsimimi: Shkollë e mesme;

2.2. Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune.

3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – X10.

KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 53

Emërtimi i vendeve të punës, pagat dhe përshkrimi i detyrave

1. Personelit sipas klasifikimit paraprak të vendeve të punës, iu zëvendësohen, plotësohen dhe harmonizohen aktet individuale të marrëdhënies së punës, në përputhje me ndryshimet sipas kësaj Rregulloreje.

2. Përgatitja e përshkrimit të detyrave të punës për pozitat e reja dhe përditësimi për pozitat ekzistuese, koordinohet nga Departamenti për Menaxhimin e Burime Njerëzore në bashkëpunim me njësitë tjera organizative, në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje. Auditori i Përgjithshëm i miraton të gjitha përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësitë të punës.

Neni 54

Dispozitat përfundimtare

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje nxjerren akte përkatëse.

2. Klasifikimi i pozitave sipas kategorisë, klasës, koeficientit dhe numri të të punësuarve, në ZKA paraqitet në Shtojcën një (I) dhe Organogrami i ZKA-së në Shtojcën dy (II), të kësaj Rregulloreje që janë pjesë përbërëse të saj.

Neni 55

Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë nga Auditori i Përgjithshëm, në përputhje me nevojat ligjore dhe organizative.

Neni 56

Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet:


1.1. Rregullorja (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Neni 57

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Vlora SPANCA



Auditore e Përgjithshme

SHTOJCA I- Klasifikimi i pozitave sipas kategorisë, klasës, koeficientit dhe numri të të punësuarve në ZKA

Pozicioni /Struktura	Kategoria	Klasa	Koeficienti	Numri
1. Auditor i Përgjithshëm;	/	A6	16.2	1
1.2. Udhëheqës i Kabinetit	Nëpunës Kabineti	C8	10	1
1.3. Zyrtar Ekzekutiv	Nëpunës Kabineti	C17	5.4.	1
1.4. Asistent Ekzekutiv	Nëpunës Kabineti	C17	5.4.	1
1.5. Vozitësi	Nëpunës Kabineti	C22	4.3	1
1.6. Këshilltar	Nëpunës Kabineti	C12	9	1
Totali i të punësuarve është				6
2. Zëvendës Auditor i Përgjithshëm	Drejtuës i lartë	A-9	13.8	1
3. Ndihmës Auditorët e Përgjithshëm	Drejtuës i lartë	A10	13.2	5
4. Drejtor i Përgjithshëm	Drejtuës i lartë	X3	12.2	1
5. Drejtor i Departamentit të Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë	Drejtuës i mesëm I	B5	12	9
5.1. Auditor Senior	Profesional	Z-2	9	52
5.2. Auditor	Profesional	Z-3	8	14
5.3. Auditor Junior	Profesional	Z-4	7	21
5.4. Ekspert i Auditorit në Fushën e Ndërtimitarisë	Profesional	Z-1	10	2
Totali i të punësuarve në këto Departamente është				98
6. Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës	Drejtuës i mesëm I	B5	12	2
6.1. Auditor Senior i Performancës	Profesional	Z-2	9	8
6.2. Auditor i Performancës	Profesional	Z-3	8	3
6.3. Auditor Junior i Performancës	Profesional	Z-4	7	5
Totali i të punësuarve në këto Departamente është				18
7. Drejtor i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit	Drejtuës i mesëm I	B5	12	1
7.1. Ekspert i Auditimit të TIK-ut	Profesional	B6-3	11	1
7.2. Auditor Senior i TI-së	Profesional	Z-2	9	2
7.3. Auditor i TI-së	Profesional	Z-3	8	2

Totali i të punësuarve në këtë Departament është						6
8. Drejtor i Departamentit për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza	Drejtes i mesëm 1	B5	12	1		
8.1. Auditor Specialist për Planifikim Strategjik, Raportim dhe Analiza	Profesional	Z-1	10	1		
8.2. Analist për Planifikim dhe Raportim	Profesional	Z3	8	1		
Totali i të punësuarve në këtë Departament është						3
9. Drejtor i Departamentit për Metodologji në Auditim	Drejtes i mesëm 1	B5	12	1		
9.1. Auditor Specialist për Metodologji	Profesional	Z-1	10	3		
Totali i të punësuarve në këtë Departament është						4
10. Drejtor i Departamentit për Sigurimin e Cilësisë në Auditim	Drejtes i mesëm 1	B5	12	1		
10.1. Auditor Specialist për Sigurimin e Cilësisë	Profesional	Z-1	10	3		
Totali i të punësuarve në këtë Departament është						4
11. Drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve	Drejtes i mesëm 1	B5	12	1		
11.1. Udhëheqës i Njësisë Kundër Mashtrimeve	Drejtes i ultë 1	B7	10	1		
11.1.1. Këshilltar i Lartë Juridik Kundër Mashtrimeve	Profesional	X1	9	2		
11.2. Udhëheqës i Njësisë për Çështje Juridike dhe Përfaqësim Gjyqësor	Drejtes i ultë 1	B7	10	1		
11.2.1. Këshilltar i Lartë Juridik për Çështje Juridike dhe përfaqësim Gjyqësor	Profesional	X1	9	3		
11.2.2. Këshilltar Juridik për Çështje Juridike dhe përfaqësim Gjyqësor	Profesional	X2	8	1		
Totali i të punësuarve në këtë Departament është						9
12. Drejtor i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim	Drejtes i mesëm 1	B5	12	1		
12.1. Zyrtar për Bashkëpunim	Profesional	X6	5.8	1		
12.2. Zyrtar për Komunikim me Publikun	Profesional	X6	5.8	2		
12.3. Zyrtar për Dizajn dhe Grafikë të Publikimeve	Profesional	K6	8	1		
Totali i të punësuarve në këtë Departament është						5
13. Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Drejtes i mesëm 2	X4	8.5	1		
13.1. Zyrtar për Burime Njerëzore	Profesional	X7	5.25	1		
13.2. Zyrtar për Zhvillim Profesional	Profesional	X6	5.8	1		

13.3. Zyrtaar për Administrim të Dokumenteve	Profesional	X7	5.25	1
Totali i të punësuarve				
4				
14. Drejtor i Departamentit për Buxhet, Financa dhe Raportim	Drejtuues i mesëm 2	X4	8.5	1
14.1. Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	Drejtuues i ultë 2	X5	7.4	1
14.2. Zyrtaar i lartë për Buxhet dhe Financa	Profesional	X6	5.8.	1
14.3. Zyrtaar për Buxhet dhe Financa	Profesional	X7	5.25	1
Totali i të punësuarve në këtë Departament është				
4				
15. Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përbashkëta	Drejtuues i mesëm 2	X4	8.5	1
15.1. Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë	Drejtuues i ultë 2	X5	7.4	1
15.1.1. Zyrtaar për Logjistikë	Profesional	X7	5.25	1
15.1.2. Vozitës	Mbështetës	X10	3.98	3
15.1.3. Mirëmbajtës i Objektivit dhe Shërbimeve Postare	Mbështetës	X10	3.88	1
15.2. Udhëheqës i Divizionit për Përkthim dhe Lekturë	Drejtuues i ultë 2	X5	7.4.	1
15.2.1. Lektor	Profesional	E9	7.5	1
15.2.2. Përkthyes	Profesional	X6	5.8	3
15.3. Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Dokumentacionit	Drejtuues i ultë 2	X5	7.4	1
15.3.1. Zyrtaar për Regjistrim dhe Ruajtje të Materialit Arkivor	Profesional	X6	5.8	1
Totali i të punësuarve në këtë Departament është				
14				
16. Drejtor i Departamentit për Teknologji të Informacionit	Drejtuues i mesëm 1	B5	12	1
16.1. Administrator i Sistemit	Profesional	B6	11	1
16.2. Administrator i Bazave të Dhënave	Profesional	B6	11	1
16.3. Specialist i Teknologjisë së Informacionit për Rrjet dhe Harduer		B7	10	1
16.4. Specialist i Mbështetjes për Sisteme		B7	10	1
Totali i të punësuarve në këtë Departament është				
5				
17. Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm	Drejtuues i mesëm 2	W7	8.5	1
17.1. Auditor i Brendshëm	Profesional 1	W13	6.4	1
Totali i të punësuarve në këtë Departament është				
2				

18. Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit	Drejtuës i mesëm 2	X4	8.5	1
18.1. Zyrtar për Prokurim	Profesional	X6	5.8	1
Totali i të punësuarve në këtë Njësi është				
19. Zyrtar Certifikues	Profesional	X5	7.4	1
Totali i të punësuarve në ZKA është				
192				

SHTOJCA II- Organogrami i Zyrës Kombëtare të Auditimit

